



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10.09.2024

Nr: 174

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. MIFTAR TAHIR DAUTI, KRYETAR BASHKIE NË BASHKINË HAS, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot në datën. 10.09.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti, kryetar në Bashkinë Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

**Palë të interesuara:** Z. Miftar Tahir Dauti, kryetar në Bashkinë Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**Baza ligjore:** Nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; pikat 12 dhe 13 të kreut V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Data: 10.09.2024 Nr:174  
Ora:12:00



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti, Kryetar Bashkie në Bashkinë Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë”

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

## VËREJ:

### I

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kryetari i bashkisë.

Z. Miftar Tahir Dauti, është propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, si kandidat për kryetar në Bashkinë Has, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Për këtë kandidat në datën 31.03.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik KU-BF-14384. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Miftar Tahir Dauti, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti është i rehabilituar.
- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Me vendimin nr. 585, datë 24.05.2023 të KSHZ-së, z. Miftar Tahir Dauti, i është dhënë mandati i kryetarit të Bashkisë Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

### II

Instituti i Studimeve Politike i është drejtuar KQZ-së me shkresën nr. 5928, datë 09.06.2023 me anë të cilës ka kërkuar verifikimin e pastërtisë së figurës të kryetarit të Bashkisë z. Miftar Tahir Dauti, pasi sipas tyre subjekti vetëdeklarues rezulton që nuk ka deklaruar të dhëna të cilat lidhen me ndalime dhe dënime nga organet ligjzbatuese.

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 5989 prot., datë 13.06.2023, vendosi t'ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 366/61 ext 23 prot., datë 16.08.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin "Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Miftar Tahir Dauti, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezulton të ketë gjeneralitete me të dhënat: emrin Myftar, mbiemrin Dauti, emri i babait Tahir, emi e nënës Zejnepe, datëlindja 20.04.1967, vendlindja Golaj, Kukës, të cilat nuk janë kërkuar të ndryshohen në emrin Miftar dhe emrin e nënës Zejnep apo Zenepe si dhe vendin e lindjes Has, hedhur gabim në RKGJC të vitit 1974 dhe vitit 2010;
- Rezulton të jetë dënuar me 4 muaj heqje lirie, nga Gjykata e Rrethit Berat, me vendim të formës së prerë nr. 78, datë 01.07.1988, për kryerjen e veprës penale të "Largimit pa leje nga vendi i internimit", në bazë të nenit 117 e 31/b të Kodit Penal;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të jetë:
  - gjykuar, nga Gjykata e Rrethit Berat, me vendim të formës së prerë nr. 78, datë 01.07.1988, për kryerjen e veprës penale të "Largimit pa leje nga vendi i internimit", në bazë të nenit 117 e 31/b të Kodit Penal;
  - në hetim, pa u regjistruar emri në cilësinë e personit nën hetim, nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në kuader të procedimit penal nr. 138 të regjistruar më datë 06.06.2023, për veprën penale të "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal;
- Rezulton të jetë arrestuar më datë 1.9.1988, nga organet ligjzbatuese, dhe vuajtur dënimin me 4 muaj heqje lirie në Repartin nr. 301 Batër nga ku është liruar më 24.12.1988;
- Nuk rezulton dokumentacion për masë sigurimi personal të caktuar për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
  - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
  - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
  - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve.

### III.

Data: 10.09.2024 Nr:174  
Ora:12:00



"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti, Kryetar Bashkie në Bashkinë Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë"

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se subjekti vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti, kryetar i Bashkisë Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; pikat 12 dhe 13 të kreut V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

### **V E N D O S A:**

1. Z. Miftar Tahir Dauti, Kryetar i Bashkisë Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të Kryetarit të Bashkisë.
2. Vazhdimin e mandatit të z. Miftar Tahir Dauti, Kryetar i Bashkisë Has.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**